

# ANALIZË KRAHASUESE

**Përmbledhje nga puna e kuvendeve të komunave të Regjionit të Prizrenit  
(Prizren, Suharekë, Rahovec, Malishevë, Dragash, Mamushë)**



**Janar 2011**



**PERSONELI:**

Ismet KRYEZIU - *Drejtor Ekzekutiv*  
Vjollca VOGËL - *Menaxhere e administratës dhe financave*  
Leonora CIKAJ - *Asistente për administratë dhe financa*  
Arsim GJINOVC I - *IT & design*

3

**PROGRAMI - QEVERISJA QENDRORE:**

Kreshnik Basha - *Menaxher programi*  
Driton SELMANAJ - *Asistent i programit*  
Isuf ZEJNA - *Monitorues*  
Besnik RAMADANAJ - *Monitorues*  
Liridon SELMANI - *Monitorues*

**PROGRAMI - QEVERISJA LOKALE**

Naim CAHANAJ - *Koordinator*

**PROGRAMI - TRANSPARENCA DHE ANTIKORRUPSIONI**

Merita MUSTAFA - *Menaxhere e programit*  
Esat MAZREKU - *Koordinator*  
Enis XHEMAJLI - *Lead Researcher*  
Natyra KASUMAJ - *Assistant Researcher*

## Përmbajtja

4

Hyrje.....	5
Numri i anëtareve pranë kuvendeve të komunave.....	6
Seancat e mbajtura gjatë vitit 2010.....	6
Seancat e mbajtura gjatë muajit Tetor-Dhjetor 2010.....	7
• Përmbledhje nga seancat.....	7
o Prizren.....	8
o Suharekë.....	9
o Rahovec.....	9
o Malishevë.....	10
o Dragash.....	11
o Mamushë.....	11
o Konkluzion.....	12
Decentralizimi ne fushën e Pylltarisë.....	12
• Masat që duhet të ndërmerren.....	14
• Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural.....	14
• Agjencioni i Pylltarisë i Kosovës.....	14
• Komunat.....	14
Realizimi i buxheteve komunale gjatë vitit 2010.....	16
o Shpenzimet e komunave gjatë vitit 2010.....	16
o Trendi i shpenzimeve 2010.....	17
o Të hyrat e komunave gjatë vitit 2010.....	18
o Trendi i të hyrave 2010.....	19
o Bilanci vjetor i komunave.....	21

## Hyrje

**N**ë kuadër të funksionimit të qeverisjes së mirë në nivel lokal, rritjes së nivelit të pjesëmarrjes së qytetarëve në vendimmarrje dhe sigurimit të transparencës me punën e institucioneve të vetëqeverisjes lokale, Instituti Demokratik i Kosovës (KDI) në vazhdimësi bënë monitorimin e punës së gjashtë kuvendeve të komunave të Regjionit të Prizrenit.

Monitorimi i KDI-së është në funksion të vlerësimit periodik të punës së përfaqësuesve të qytetarëve në kuvendet e komunave të Regjionit të Prizrenit dhe të subjekteve politike të përfaqësuara në to. Dimensionin tjetër të punës së KDI-së është edhe hartimi i raporteve periodike krahasuese mbi çështje të rëndësishme të sistemit të vetëqeverisjes lokale në këtë regjion.

Me anë të kësaj analize, synohet që qytetarit t'i paraqitet një përmbledhje rreth raporteve të kuvendeve të komunave të Regjionit të Prizrenit, bartja e kompetencave nga niveli qendror në nivel lokal që ka përcjell procesin e decentralizimit, punën e kuvendeve të komunave të Regjionit të Prizrenit në periudhën Tetor-Dhjetor 2010 dhe proceset buxhetore nëpër komuna.


Njëkohësisht, "Analiza krahasuese" është planifikuar të jetë periodike me anë të së cilës parashihet që në çdo katër muaj të bëhet një analizë mbi zhvillimin e politikave në institucionet e vetëqeverisjes lokale si edhe krahasimi i këtij zhvillimi qoftë mes komunave, qoftë mes periudhave.

## NUMRI I ANËTAREVE PRANË KUVENDEVE TË KOMUNAVE

6

Qytetarët e gjashtë komunave të Regjionit të Prizrenit pranë kuvendeve të komunave i përfaqësojnë gjithsej 180 anëtarë. Këta janë të ndarë në 14 subjekte politike dhe dy prej tyre janë kandidatë të pavarur.


Nga këto, në gjashtë kuvendet e komunave të Regjionit të Prizrenit subjekti politik i PDK-së përfaqësohet me 57 anëtarë, LDK me 50 anëtarë, AAK me 26 anëtarë, KDTP me 14 anëtarë dhe subjektet tjera janë të përfaqësuar me më pak anëtarë.



Ndër gjashtë komunitat e këtij regjioni, PDK udhëheq me tri komuna, derisa AAK pas zgjedhjeve në Rahovec udhëheq me dy komuna dhe KDTP udhëheq me një komunë.

### Seancat e mbajtura gjatë vitit 2010

Gjatë vitit 2010, në kuvendet e komunave të Regjionit të Prizrenit janë thirrur gjithsej 62 mbledhje. Një nga seancat e thirrura ka dështuar ndërsa seancat tjera kanë qenë të rregullta në përjashtim të kuvendit të komunës së Prizrenit<sup>1</sup>.




Numrin më të madh të seancave të mbajtura në periudhën Janar-Dhjetor 2010 e ka arritur Kuvendi i Komunës së Suharekës, e cila në këtë periudhë ka realizuar gjithsej trembëdhjetë seanca. Krahas kësaj, Kuvendi i Komunës së Malishevës ka mbajtur dymbëdhjetë seanca, Kuvendi i Komunës së Mamushës me njëmbëdhjetë seanca, Kuvendi i Komunës së Dragashit me dhjetë seanca, Kuvendi i Komunës së Rahovecit me nëntë seanca dhe Kuvendi i Komunës së Prizrenit vjen në fund të kësaj liste me vetëm shtatë seanca të mbajtura gjatë vitit 2010.

<sup>1</sup> Një seancë e thirrur nga KK Prizrenit është kërkuar të përsëritet nga MAPL

## Seancat e mbajtura gjatë muajit Tetor-Dhjetor 2010

Gjatë periudhës Tetor-Dhjetor 2010, në kuvendet e komunave të Regjionit të Prizrenit janë mbajtur gjithsej 11 seanca. Të gjitha këto seanca kanë qenë të thirrura si të rregullta ndërsa njëra nga seancat e thirrura nga Kuvendi i Komunës së Suharekës ka dështuar si pasojë e mos miratimit të rendit të ditës nga ana e anëtarëve.

7



Numri i mbledhjeve Tetor-Dhjetor 2010

### Përmbledhje nga seancat

Në kuadër të monitorimit të punës së kuvendeve të komunave të Regjionit të Prizrenit, Instituti Demokratik i Kosovës (KDI), ka vazhduar me monitorimin e punës së këtyre institucioneve edhe gjatë periudhës Tetor-Dhjetor 2010.

## Prizren

8

Kuvendi i Komunës së Prizrenit gjatë vitit 2010 ka thirrur shtatë mbledhje duke përfshirë edhe mbledhjen konstituive të këtij organi. Dy nga mbledhjet e thirrura në Kuvendin e Komunës së Prizrenit kanë dështuar dhe atë njëra për shkak të ndërprerjes së saj nga Kryesuesi i Kuvendit dhe tjetra për shkak të mungesës së kuorumit si pasojë e mos pjesëmarrjes së anëtarëve nga ana e bllokut opozitarë.

Kuvendin e Komunës së Prizrenit edhe muajt e fundit të vitit 2010 e kanë përcjellë pa aktivitete. Në periudhën Tetor-Dhjetor 2010 ky institucion ka mbajtur vetëm një seancë çka do të thotë për performacën e ultë të këtij organi si organ më i lartë të vetëqeverisjes lokale. Përveç tjerash këtë institucion e kanë përcjellë shkeljet e vazhdueshme ligjore që nga konstituimi i tij pas zgjedhjeve të vitit 2009.

**Sipas Ligjit për Vetëqeverisje Lokale, Kuvendi i Komunës është i obliguar ti mban së paku dhjetë seanca në vit, ku pesë prej të cilave duhet të mbahen gjatë gjashtë muajve të parë të vitit. Duke u bazuar në këtë dhe realizimin e mbledhjeve nga ana e Kuvendit të Komunës së Prizrenit nuk është respektuar ky kriter ligjorë.**

Më datë 19.11.2010, Kuvendi i Komunës së Prizrenit ka disa vendime. Ndër vendimet e marra në këtë seancë ishin: vendimin për ndryshimin dhe plotësimin e rregullores së Kuvendit të Komunës për tarifatat dhe ngarkesat, shërbimet dhe veprimtarin komunale nr. 01/011-4099 të datës 18 qeshor 2009, vendimin për rikonfirmimin e shkallës tatimore të përcaktuar në nenin 2 të rregullores së Kuvendit të Komunës mbi përcaktimin e aplikimit të tatimit në pronën e patundshme në Komunën e Prizrenit nr.01/011-5059 të datës 29 shtator 2008, vendimin mbi dhënien në shfrytëzim të trojeve ndërtimore për rastet sociale dhe vendimi rreth ndërrimit të ngastrës kadastrale.

Po ashtu gjatë kësaj periudhe ka vazhduar trendi i bojkotit të punës nga ana e anëtarëve të opozitës që përfaqësohen në këtë institucion.

**KDI konsideron se është obligim i të gjithë anëtarëve të Kuvendit të Komunës së Prizrenit pjesëmarrja në të gjitha mbledhjet e këtij organi në përputhje me Nenin 39.8 të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale**

Me qëllim të zhbllokimit të punës së këtij institucioni Ministria e Administrimit dhe Pushtetit Lokal duhet të ndërmer masat adekuate si organ mbikëqyrës së punëve të organeve të vetëqeverisjes lokale.



## Suharekë

Kuvendi i Komunës së Suharekës gjatë vitit 2010 ka mbajtur dymbëdhjetë mbledhje në të cilat janë trajtuar disa çështje me interes të drejtpërdrejtë për qytetarët e kësaj komune.

Në periudhën Tetor-Dhjetor 2010, Kuvendi i Komunës së Suharekës ka thirrur tri mbledhje njëra prej të cilave ka dështuar si pasoj e mos miratimit të rendit të ditës nga ana e anëtarëve të Kuvendit të Komunës.

**Në seancën e dështuar të datës 30.11.2010, Kryesuesi i Kuvendit të Komunës së Suharekës ka bërë shkelje të nenit 47.2 dhe 43.7 të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale si pasoj e mos futjes në votim të propozimit për pikë shtesë për rendin e ditës nga ana e anëtarëve.**

Më datë 29.10.2010, Kuvendi i Komunës së Suharekës ka marrë disa vendime ndërsa seanca e datës 30.12.2010 ka qenë përmbyllëse dhe ka dhënë betimin një anëtarë i ri i cili vjen nga subjekti politik i PDK-së. Ndër vendimet më të rëndësishme të marra ishin: shqyrtimi i projekt rregullores për ndarjen e bursave për nxënës/studentë të Komunës së Suharekës dhe vendim për ndarjen e druve për familjarët e dëshmorëve dhe familjet skamnore.

## Rahovec

Kuvendin e Komunës së Rahovecit, gjatë vitit 2010 ka thirrur 9 mbledhje, dy prej të cilave kanë dështuar, njëra për shkak të mungesës së kuorumit dhe tjetra për shkak të mos miratimit të rendit të ditës nga ana e anëtarëve.

Gjatë muajt Tetor-Dhjetor 2010, Kuvendi i Komunës së Rahovecit ka thirrur dy mbledhje atë të datës 14.10.2010 dhe 16.12.2010. Në seancën e datës 14.10.2010 është marrë vendim për vendosjen e Lapidarit "Toni dhe Minci" në parkun e qytetit të Rahovecit, janë shqyrtuar propozimet e komisionit për plotësimin dhe ndryshimin e Statutit të Komunës së Rahovecit si dhe është shqyrtuar gjendja e dëmtimit të tokës punuese rreth shtratit të lumit Drini i Bardhë në territorin e Komunës së Rahovecit..

Në seancën e datës 16.12.2010, Kuvendi i Komunës së Rahovecit ka marrë vendim për ndryshimin e Statutit të Komunës së Rahovecit

**Sipas Ligjit për Vetëqeverisje Lokale, Kuvendi i Komunës është i obliguar ti mban së paku dhjetë seanca në vit, ku pesë prej të cilave duhet të mbahen gjatë gjashtë muajve të parë të vitit. Duke u bazuar ne këtë dhe realizimin e mbledhjeve nga ana e Kuvendit të Komunës së Rahovecit nuk është respektuar ky kriter ligjorë.**

## Malisheve

10

Kuvendi i Komunës së Malishevës gjatë vitit 2010 ka thirrur 12 mbledhje dhe të gjitha mbledhje janë mbajtur.

Në dy nga seancat e mbajtura në fillim të këtij viti, për punë normale të Kuvendin e Komunës së Malishevës ka qenë tejet shqetësuese “ bojkoti” në heshtje mbi pikat e rendit të ditës nga ana e Grupit Parlamentar të LDK-së si dhe mos gatishmëria e Qeverisë lokale në ofrimin e përgjigjeve në pyetjet e anëtarëve të Kuvendit të Komunës së Malishevës.

Një situatë e tillë tashmë është tejkaluar dhe opozita përfaqëson interesin e qytetarëve pranë këtij institucioni dhe Qeveria lokale është treguar më e gatshme në ofrimin e përgjigjeve të kërkuara nga grupi opozitarë.

Ajo çka është vë re në periudhën e dytë të vitit 2010 na Kuvendin e Komunës së Malishevës është mos shtimi i aktiviteteve në drejtim të mbajtjes së seancave krahasuar me periudhën paraprake të gjysmë mujorit të vitit 2010.

Përderisa Kuvendi i Komunës së Malishevës në gjashtë mujorin e parë ka pri për nga numri i mbajtjes së seancave në Regjionin e Prizrenit, në gjashtë mujorin e dytë ka realizuar vetëm tri të tilla.

Gjatë periudhës Tetor-Dhjetor, Kuvendi i Komunës së Malishevës ka mbajtur vetëm një seancë me datë 30.11.2010. Në këtë seancë, Kuvendi i Komunës së Malishevës ka marrë vendim që të shtoj listën e projekteve kapitale për vitin 2011. Ajo çka vlen të theksohet në këtë mes se kjo listë e projekteve kapitale ishte pjesë e kërkesës së Kryetarit mirëpo pa mbulesë nga buxheti i Komunës së Malishevës. Kjo listë e projekteve kapitale mundë të realizohet vetëm nga financimet me fonde shtesë që mund të sigurohen gjatë vitit fiskal 2011.

## Dragash

Kuvendi i Komunës së Dragashit gjatë vitit 2010 ka mbajtur dhjetë seanca që nga konstituimi i këtij organi pas zgjedhjeve të nëntorit 2009.

Kuvendin e Komunës së Dragashit, gjatë gjashtë mujorit të parë dhe gjashtë mujorit të dytë të vitit 2010 e ka përcjellë një tempo standard në drejtim të mbajtjes së mbledhjeve dhe trajtimit të çështjeve me interes për qytetarët e kësaj komune.

Gjatë periudhës Tetor-Dhjetor, Kuvendi i Komunës së Dragashit ka realizuar vetëm një mbledhje, e cila është mbajtur më datë 02. 11. 2010. Në këtë seancë Kuvendi i Komunës së Dragashit ka shqyrtuar Raportin mbi realizimin e buxhetit të Komunës për periudhën janar-shtator 2010 si dhe ka miratuar dy kërkesa të Drejtorisë së Urbanizmit rreth ndërrimit të kulturës së tokës.

## Mamushë

Kuvendi i Komunës së Mamushës gjatë vitit 2010 ka vazhduar me trend pozitiv të mbajtjes së seancave duke arritur që ti mbaj njëmbëdhjetë të tilla.

Gjatë periudhës tetor-dhjetor 2010, Kuvendi i komunës së Mamushës ka arritur ti mbaj tri seanca. Në seancën e datës 27.10.2010, Kuvendi i Komunës së Mamushës ka marrë vendim për miratimin e Rregullores për tatimin mbi pronën e paluajtshme ndërsa në seancën e datës 26.11.2010, është miratuar draft Rregullorja për tarifa, obligime dhe dënimet lidhur me aktivitetet dhe shërbimet komunale.

Në seancën e 30.12.2010, Kuvendi i komunës së Mamushës ka marrë vendim për miratimin e draft rregullores për mbrojtjen e mjedisit. Vlen të cekte se kjo rregullore është propozuar nga ana e KDI-së për miratim në Kuvendin e Komunës së Mamushës.

## Konkluzion

Kuvendet e Komunave të Regjionit të Prizrenit, me punën e tyre gjatë vitit 2010 në përgjithësi kanë treguar nivel mesatar të angazhimit, në drejtim të përfaqësimit të kërkesave dhe brengave të qytetarëve të komunave përkatëse. Krahas kësaj, në shumë raste këto institucione kanë treguar prirje të theksuar për shkelje të procedurave dhe ligjeve në fuqi.

Në periudhën Janar-Dhjetor 2010 janë evidentuar me dhjetëra raste të shkeljeve ligjore nga kuvendet e komunave të Regjionit të Prizrenit dhe asnjë nga këto institucione nuk ka bën përjashtim nga ky cilësim. Dallimi i vetëm në mes kuvendeve të komunave të Regjionit në këtë aspekt konsiston në numrin e shkeljeve të realizuara gjatë kësaj periudhe.

Duke u bazuar në monitorimet e vazhdueshme të kuvendeve të komunave të Regjionit të Prizrenit, KDI ka hasur në shkeljet e shumta të cilat janë bërë nga organi më i lartë i vetëqeverisjes lokale. Një ndër shkeljet më serioze kanë qenë: shkarkim i kryesuesit pas mbylljes së seancës<sup>2</sup>, mos themelimi i komiteteve obligative<sup>3</sup>, udhëheqja e seancës konstituive nga kryetari i komunës<sup>4</sup>, mos përfaqësimi adekuat në përbërjen e komitetit për komunitete<sup>5</sup> etj.

Shqetësuese në këtë mes ka qenë edhe mungesa e efikasitetit të Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal (MAPL) në drejtim të kontrollit të organeve të vetëqeverisjes lokale për zbatim të plotë të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale dhe ligjeve tjera. Kjo vlen edhe më shumë kur kihet parasysh se kjo ministri është përgjegjëse për mbikëqyrjen e punës së organeve të pushtetit lokal.

## Decentralizimi në fushën e Pylltarisë

Një ndër sfidat të cilat po përballën administratat Komunale në regjionin e Prizrenit padyshim është edhe mbrojtja e pyjeve në kuadër të territorit administrativ të komunës gjegjëse. Fare mirë dihet se problematika e mbrojtjes së pyjeve shumë herë ka qenë edhe shënjestër të shume diskutimeve në forume të ndryshme. Thuaja në të gjitha debatet e organizuara qoftë nga shoqëria civile ashtu edhe nga institucionet ka dalë në shprehje përzierja e kompetencave, mungesa e kapaciteteve njerëzore në nivel komune dhe mungesa e akteve rregullative për çështjet specifike në fusha të ndryshme si pyjet, mbrojtja e mjedisit lokal, mbrojtja e tokës bujqësore etj. Pylltaria ka qenë pjesa më së paku e debatuar në vitet e fundit.

Me qëllim të mbrojtës së pasurisë pyjore të Kosovës janë nxjerrë edhe shume akte normative të cilat ishin edhe bazë e mirë ligjore për parandalimin e degradimit të sistemit

<sup>2</sup> Komuna e Rahovecit

<sup>3</sup> Komuna e Prizrenit

<sup>4</sup> Komuna e Malishevës

<sup>5</sup> Komuna e Malishevës

pyjor në Kosovë por edhe tendencat për revitalizimin e këtij sektori tejet të rëndësishëm.

Ligji për Pyjet e Kosovës i nxjerrë në vitin 2003 në vete kishte paraparë themelimin e një Agjencie Ekzekutive përkatësisht Agjencinë Pyjore të Kosovës (APK). Ky ligj, këtij autoriteti i kishte mbartur përgjegjësin përgjegjës për çështjet e ndërlidhura në rregullimin e pyjeve, tokave pyjore private, menaxhimin dhe administrimin e pyjeve dhe tokave pyjore publike si dhe pyjeve në parqet nacionale në Kosovë.<sup>6</sup>

Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural (MBPZHR) është autoriteti më i lart përgjegjës për pylltari në Kosovë. Në nivelin qendror janë dy njësi kryesore përgjegjëse për pylltari: Departamenti i Pylltarisë (DP) dhe Agjencioni i Pyjeve të Kosovës (APK).<sup>7</sup>

Ndër kompetencat e Departamentit të Pylltarisë përfshihen: hartimi dhe zhvillimi i politikave pyjore, zhvillimi i sistemit të arsimimit, trajnimit dhe këshillimit nga lëmia e pylltarisë, mbikëqyrja dhe implementimi i Ligjit dhe akteve nënligjore të cilat kanë të bëjnë me pylltarinë, organizimi dhe mbikëqyrja e pyllëzimit të pyjeve të degraduara dhe tokave pyjore të zhveshura, erozive, monitorimi dhe kontrollimi i pyjeve, lëshimi i licencave (leje) për ushtrimin e veprimtarisë në pylltari ( shfrytëzim të pyjeve dhe produkteve tjera drunore, fidanët ), për prodhuesit, përpunuesit dhe treg etj.

APK i ka katër drejtori qendrore (drejtoria për menaxhim me pyje, drejtoria për menaxhim me kullosa, kafshë të egra, gjueti dhe ekoturizëm, drejtoria për silvikulturë, hulumtim dhe prodhim fidanor dhe drejtoria e administratës së përgjithshme), gjashtë drejtori koordinuese rajonale që koordinojnë aktivitetet pyjore përmes 29 njësive komunale, ndërsa një prej detyrave kryesore të këtyre njësive është bashkëpunimi me qeveritë lokale (komunat). APK operon me një fidanishte që gjendet afër qytetit të Pejës. Aty kryesisht prodhohen fidanë të specieve halore dhe ofrohen materiale mbjellëse për 300 – 500 ha që mbillen në vit.<sup>8</sup>

Ligji për Vetëqeverisje Lokale në kuadër të kompetencave të deleguara parasheh edhe mbrotjen e pyjeve që ndodhen në territorin e komunës në kuadër të autorizimeve të deleguara nga autoriteti qendror, duke përfshirë edhe dhënien e licencave për prerjen e drunjve në bazë të rregullave të miratuara nga Qeveria<sup>9</sup>.

Kompetencat e deleguara duhet, në të gjitha rastet, të shoqërohen me financim të nevojshëm në përputhje me objektivat, standardet dhe kërkesat e përcaktuara nga Qeveria e Republikës së Kosovës<sup>10</sup>.

<sup>6</sup> Neni 8 il Ligjit për Pyjet, [http://assembly-kosova.org/common/docs/ligjet/2003\\_3\\_al.pdf](http://assembly-kosova.org/common/docs/ligjet/2003_3_al.pdf)

<sup>7</sup> Strategjia për zhvillimin e Pylltarisë 2010-2010, <http://www.ks-gov.net/Mbpzhr/LinkClick.aspx?fileticket=5ZNApzsLGds%3d&tabid=76&mid=453&language=sq-AL>

<sup>8</sup> Po aty, fq 11

<sup>9</sup> Neni 18 I Ligjit për Vetëqeverisje Lokale

<sup>10</sup> Po aty neni 18.3 I Ligjit për Vetëqeverisje Lokale

## MASAT QË DUHEN TË NDËRMERREN

14

### Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural:

Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural ka filluar për pregaditjet e ligjit të ri për pyjet. Me qëllim që të definohen qartë kompetencat e komunave mbi fushën e pylltarisë kjo Ministri duhet të merr inputet e komunave dhe ekspertëve në lëmin e pylltarisë përkitazi me menaxhimin e qëndrueshëm të pyjeve në nivel lokal. Me qëllim të menaxhimit sa më adekuat Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural duhet ta shqyrtojë mundësin e ndryshimit të ligjit në të cilën duhet të parashihen dy nivele të organizimit pyjorë- menaxhimi me pyje me kompetenca të qarta çka do të thotë një ndarje strikt në mes nivelit qendror dhe atij lokal.

### Agjencioni i Pylltarisë të Kosovës (APK)

Edhe përkundër faktit që disa nga kompetencat në menaxhimin e pyjeve kanë kaluar në nivel lokal duke përfshirë edhe stafin teknik në kuadër të AKP-së, problematika qëndron tek ekspertët që veprojnë në kuadër të këtij Agjencioni dhe nuk kanë kaluar në kompetencë të nivelit lokal<sup>11</sup>.

Me qëllim që të kemi një bartje më të mirë të kompetencave ky agjencion duhet të riorganizohet ku duhet të futet në kuadër të Departamenti të Pylltarisë si inspektion pyjor më i zgjeruar. Drejtoritë koordinuese rajonale në kuadër të APK-së të shpërbëhen dhe pjesa e teknikëve dhe nga një inxhinier i pylltarisë të kalojnë nëpër komuna dhe pjesa tjetër të integrohet në strukturat e lartpërmendura<sup>12</sup>.

### Komunat:

Sipas kryeshefit të APK-së, tash edhe komunat kanë përgjegjësi në mbrojtjen e pyjeve nga prerësit ilegal. “Nga korriku i vitit 2010 të gjitha komunat obligohen që t’i mbrojnë yjet, por nuk i kanë të gjitha kompetencat, por disa nga kompetencat. I gjithë stafin i mbrojtjes së pyjeve ka kaluar në nivele komunale. Të 266 punëtorët nga Agjencia e Pyjeve kanë kaluar nëpër komuna, duke përfshirë përgjegjësin e njësisë komunale, një pjesë të teknikëve dhe i gjithë stafi i rojeve të pyllit”.<sup>13</sup>

Bartjes së kompetencave në nivele lokal i ka parapri memorandumimi i mirëkuptimit. Tani më si komunë kemi nën menaxhim pyjet mirëpo ky menaxhim është i pjesëriëshëm. Tanimë kemi edhe kompetencën e prerjes së drunjve mirëpo edhe këtu janë procedura të koklavitura ku duhet të jetë prezent edhe eksperti nga AKP-ja dhe kjo na bënë të pafuqishëm në drejtim të dhënies së lejeve. Një tjetër kompetencë që na është bartë janë edhe tenderimi (shitja) e drunjve mirëpo të gjitha ato pagesa nga shitja e drunjve shkojnë në buxhetin e Ministrisë së Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural dhe 1/3 e tyre i kthehet buxhetit komunal, shumë kjo tejet e vogël për menaxhim të mirëfillt të pyjeve.<sup>14</sup>

<sup>11</sup> Intervistë me z. Bedri Berisha –Drejtor në Drejtorin e Bujqësisë dhe Zhvillimit Lokal- Suharekë

<sup>12</sup> Intervistë me z. Bedri Berisha –Drejtor në Drejtorin e Bujqësisë dhe Zhvillimit Lokal- Suharekë

<sup>13</sup> <http://www.ekonomia-ks.com/?page=1,5,8070>

<sup>14</sup> Intervistë me z. Aliismet Çoçaj-Drejtor në Drejtorinë e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural-Prizren

Në kuadër të draftimi të ligjit duhet që komunave të ju epet mundësia që buxheti nga tenderimi i drunjve të mbetet në nivel lokal shumë kjo që së paku të jetë 50 : 50 me qëllim që komunat të kenë buxhet për operim të menaxhimit të pyjeve.


Po ashtu me ligjin e ri për pyjet,, komunat duhet të kenë kompetenca më të thuktë në drejtim të menaxhimit të pyjeve. Përderisa Ministria duhet të jetë në rolin e hartimit dhe zbatimit të planeve investuese, komunat duhet të fokusohen në hartimin e planeve menaxhuese mirëpo Ministria duhet të vëzhgoj dhe kontrolloj realizimin e menaxhimit të pyjeve nga Komunat.



**REALIZIMI I BUXHETEVE KOMUNALE GJATË VITIT 2010<sup>15</sup>**

Ashtu sikurse të gjitha komunat e Republikës së Kosovës, edhe gjashtë komunat e Regjionit të Prizrenit, në bazë të kriterëve të përcaktuara me Ligjin për Financat e Pushtetit Lokal, kanë të drejtë të posedojnë dhe menaxhojnë buxhetet vetanake. Në bazë të ligjit në fjalë, buxheti i komunave sigurohet nga grantet qeveritare, të hyrat vetanake, grantet për kompetencat e shtuara, grantet e jashtëzakonshme dhe forma tjera të parapara<sup>16</sup>.


Sipas kësaj, buxheti i komunave të Regjionit të Prizrenit është paraqitur grafikisht në tabelën e mëposhtme.<sup>17</sup>



Zhvillimi lokal ekonomik, ofrimi i shërbimeve publike, ofrimi i arsimit publik parashkollor, fillor dhe të mesëm, ofrimi i përkujdesjes publike primare shëndetësore janë vetëm disa nga kompetencat me të cilat komuna është e ngarkuar. Këto çështje, në të njëjtën kohë, janë absorbueset më të mëdha të buxheteve të komunave.

**o Shpenzimet e komunave për vitin 2010**

Në tabelën e mëposhtme janë paraqitur të dhëna mbi realizimin e shpenzimeve të komunave të Regjionit të Prizrenit gjatë gjithë vitit 2010.



<sup>15</sup> Pjesë nga Analiza Krahasuese, Maj 2010, KDI.

<sup>16</sup> Ligji për Financat e Pushtetit Lokal, Neni 7.

<sup>17</sup> Buxhetet e Komunave për vitin 2010 të miratuara në vitin 2009.




Nga kjo mund të shohim se Komuna e Prizrenit, gjatë vitit 2010 ka shpenzuar vetëm 98.36 % të buxhetit të paraparë për tërë vitin 2010. Komuna e Mamushës, siç edhe shihet nga grafikoni, është komuna me nivelin më të ulët të realizimit të shpenzimeve të planifikuara për këtë vit në krahasim me komunat tjera të këtij regjioni. Kjo shifër në të njëjtën kohë tregon për stagnim të Komunës së Mamushës në drejtim të realizimit të buxhetit në përputhje me planifikimet e bëra.

Në këtë segment prin Komuna e Dragashit dhe e Malishevës, tw cilat gjatë këtij viti ka shpenzuar 106.62 përkatësisht 101.76% % të buxhetit të planifikuar për tërë vitin 2010. Kjo në të njëjtën kohë flet për tejkalim në drejtim të realizmit të planit të paraparë për shpenzime gjatë këtij viti.

Krahas kësaj, komunat tjera të Regjionit të Prizrenit kanë një trend mesatar të realizimit të planeve të tyre përkatëse të shpenzimeve gjatë këtij viti në krahasim me planet e shpenzimeve për gjithë vitin 2010.

### o Trendi i shpenzimeve 2010

Në tabelën e mëposhtme është paraqitur trendi i realizimit të buxhetit në periudhën e gjashtë mujorit të parë të vitit 2010 dhe periudhën e gjashtë mujorit të dytë të vitit 2010. Ky trend tregon efikasitetin e komunave të Regjionit të Prizrenit se në cilën periudhë janë treguar më të suksesshme në shpenzimin e buxhetit.



- Komuna e Prizrenit, gjatë gjashtëmujorit të parë të vitit 2010 ka realizuar 42.50 % të buxhetit të planifikuar për gjithë vitin ndërsa në gjashtë mujorin e dytë ka realizuar 98.36 % të buxhetit të planifikuar për tërë vitin 2010.
- Komuna e Suharekës, gjatë gjashtë mujorit të parë të vitit 2010 ka realizuar 33.70 % të buxhetit të planifikuar për gjithë vitin ndërsa në gjashtë mujorin e dytë të vitit ka realizuar 97.81 % të buxhetit të planifikuar për tërë vitin 2010


- Komuna e Rahovecit, gjatë gjashtë mujorit të parë të vitit 2010 ka realizuar 33.10 % të buxhetit të planifikuar për gjithë vitin ndërsa në gjashtë mujorin e dytë ka realizuar 96.62 % të buxhetit të planifikuar për tërë vitin 2010.
- Komuna e Malishevës, gjatë gjashtë mujorit të parë të vitit 2010 ka realizuar 45.90 % të buxhetit të planifikuar për gjithë vitin 2010 ndërsa në gjashtë mujorin e dytë ka realizuar vetëm 101.7 % të buxhetit të planifikuar për tërë vitin 2010.
- Komuna e Dragashit, gjatë gjashtë mujorit të parë të vitit 2010 ka realizuar 63.40 % të buxhetit të planifikuar për gjithë vitin ndërsa në gjashtë mujorin e dytë ka realizuar 106.62 % të buxhetit të planifikuar për tërë vitin 2010.
- Komuna e Mamushës, gjatë gjashtë mujorit të parë të vitit 2010 ka realizuar 41.10 % të buxhetit të planifikuar për gjithë vitin ndërsa në gjashtë mujorin e dytë ka realizuar 90.38 % të buxhetit të planifikuar për tërë vitin 2010.

### o Të hyrat e komunave gjatë vitit 2010

Të gjitha komunat e Republikës së Kosovës, sikurse edhe ato të Regjionit të Prizrenit, buxhetin e tyre e plotësojnë edhe nga realizimi i të hyrave vetanake. Disa nga burimet e të hyrave vetanake të komunave mund të jenë taksat dhe tarifat komunale, taksat për lejen e ushtrimit të veprimtarisë afariste, taksa për automjete motorike, taksat administrative etj.<sup>18</sup>

Gjithnjë në bazë të kapaciteteve të secilës komunë për të siguruar të hyra vetanake, çdo komunë e Regjionit të Prizrenit ka hartuar planet përkatëse për shumën që synojnë ta sigurojnë nga të hyrat vetanake.

Në tabelën e mëposhtme janë dhënë hollësi mbi planifikimet e komunave të Regjionit të Prizrenit për sigurimin e të hyrave vetanake për vitin 2010 dhe realizimin e këtyre parashikimeve në përqindje për vitin 2010.



Realizimi i të hyrave gjatë vitit 2010

<sup>18</sup> Ligji për Financat e Pushtetit Lokal, Pjesa II.

Sipas të dhënave të paraqitura në tabelë, mund të shohim se Komuna e Rahovecit dhe e Suharekës kanë arritur nivelin më të lartë të sigurimit të të hyrave të planifikuara për këtë vit. Në përjashtim të Komunës së Malishevës dhe Komunës së Mamushës të cilat nuk kanë arritur ti inkasojnë të gjitha të hyrat vetanake të planifikuara për gjithë vitin , të gjitha komunat tjera të Regjionit të Prizrenit i kanë tejkaluar inkasimin e të të hyrave vetanake në raport me planifikimet për vitin 2010.


Në këtë segment Komuna e Mamushës është në gjendje të palakueshme, pasi gjatë vitit 2010 ka arritur të inkasojë vetëm 43.28 % të të hyrave të planifikuara për gjithë vitin 2010.

**Instituti Demokratik i Kosovës i bën apel të gjithë qytetarëve të secilës komunë, që të jenë në nivel të përgjegjësive të tyre dhe si qytetarë të ndërgjegjshëm t`u përgjigjen institucioneve shtetërore në kryerjen e obligimeve ligjore.**

Komuna e Mamushës dhe e Malishevës në vitin fiskal të 2011 duhet të tregojnë aktivitete të shtuar me qëllim të ruajtjes së stabilitetit financiar të komunave përkatëse dhe realizimit të të hyrave vetanake për investime kapitale.

### Trendi i të hyrave 2010

Në tabelën e mëposhtme është paraqitur trendi i realizimit të të hyrave vetanake për periudhën e gjashtë mujorit të parë të vitit 2010 dhe periudhën e gjashtë mujorit të dytë të vitit 2010. Ky trend tregon efikasitetin e komunave të Regjionit të Prizrenit se në cilën periudhë janë treguar më të suksesshme në inkasimin e të hyrave vetanake.




- Komuna e Prizrenit, gjatë gjashtëmujorit të parë të vitit 2010 ka realizuar 37.60 % të të hyrave vetanake të planifikuara për gjithë vitin ndërsa në gjashtë mujorin e dytë ka realizuar 104.59 % të të hyrave vetanake duke tejkuluar edhe parashikimet për tërë vitin 2010.
- Komuna e Suharekës, gjatë gjashtë mujorit të parë të vitit 2010 ka realizuar 54.50 % të të hyrave vetanake të planifikuara për gjithë vitin ndërsa në gjashtë mujorin e dytë të vitit ka realizuar 106.38 % të të hyrave vetanake duke tejkuluar edhe parashikimet për tërë vitin 2010.
- Komuna e Rahovecit, gjatë gjashtë mujorit të parë të vitit 2010 ka realizuar 37.80 % të të hyrave vetanake të planifikuara për gjithë vitin ndërsa në gjashtë mujorin e dytë ka realizuar 111.49 % të të hyrave vetanake duke tejkuluar edhe parashikimet për tërë vitin 2010.
- Komuna e Malishevës, gjatë gjashtë mujorit të parë të vitit 2010 ka realizuar 44.10 % të të hyrave vetanake të planifikuar për gjithë vitin 2010 ndërsa në gjashtë mujorin e dytë ka realizuar vetëm 68.14 % duke mos e arritur parashikimet për vitin 2010.
- Komuna e Dragashit, gjatë gjashtë mujorit të parë të vitit 2010 ka realizuar 43.50 % të të hyrave vetanake të planifikuara për gjithë vitin ndërsa në gjashtë mujorin e dytë ka realizuar 111.11 % të të hyrave vetanake duke tejkuluar parashikimet për tërë vitin 2010.
- Komuna e Mamushës, gjatë gjashtë mujorit të parë të vitit 2010 ka realizuar 19.70 % të të hyrave vetanake të planifikuara për gjithë vitin ndërsa në gjashtë mujorin e dytë ka realizuar 43.58 % të të hyrave vetanake duke mos arritur ti realizoj parashikimet e inkasimit të të hyrave për vitin 2010.

Nga kjo mund të konkludojmë se Komuna e Mamushës dhe e Malishevës nuk kanë arritur ti inkasojnë të hyrat vetanake të planifikuara për vitin 2010 të cilat ishin miratuar në vitin 2009 për vitin 2010.

**o Bilanci vjetor i komunave**

Në tabelën e mëposhtme është paraqitur përmbledhja me krahasimin në mes shpenzimeve të realizuara nga komunat e Regjionit të Prizrenit gjatë gjashtë mujorit të parë 2010 dhe suksesit të treguar nga këto komuna në inkasimin e të hyrave vetanake të planifikuara për gjithë vitin 2010.



**Shënim:**

Shpenzimet komunale të paraqitura në tabelë janë llogaritur mbi bazën e buxhetit total të paraparë për secilën komunë për vitin 2010 dhe realizimit të tyre në gjatë vitit 2010. Të hyrat e paraqitura shfaqin përqindjen e realizimit gjatë tërë vitit 2010, të planeve të secilës komunë për të hyrat vetanake të planifikuara për gjithë vitin 2010.

Sipas kësaj:

- Komuna e Prizrenit, gjatë vitit 2010, ka realizuar 98.36 % të shpenzimeve dhe ka inkasuar 104.59 % të të hyrave vetanake të parapara për gjithë vitin 2010.
- Komuna e Suharekës, gjatë vitit 2010, ka realizuar 97.81 % të shpenzimeve dhe ka inkasuar 106.38 % të të hyrave vetanake të parapara për gjithë vitin 2010.
- Komuna e Rahovecit, gjatë vitit 2010, ka realizuar 96.62 % të shpenzimeve dhe ka inkasuar 111.49 % të të hyrave vetanake të parapara për gjithë vitin 2010.
- Komuna e Malishevës, gjatë vitit 2010, ka realizuar 101.76 % të shpenzimeve dhe ka inkasuar 68.14 % të të hyrave vetanake të parapara për gjithë vitin 2010.
- Komuna e Dragashit, gjatë vitit 2010, ka realizuar 106.62 % të shpenzimeve dhe ka inkasuar 111.11 % të të hyrave vetanake të parapara për gjithë vitin 2010.
- Komuna e Mamushës, gjatë vitit 2010, ka realizuar 90.38 % të shpenzimeve dhe ka inkasuar vetëm 43.28 % të të hyrave vetanake të parapara për gjithë vitin 2010.







**Përkrahur nga / Supported by:**

